



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1292/2 Prot.

Tiranë, më 22. 09. 2025

**V E N D I M**

**Nr. 218, datë 22. 09. 2025**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 191, datë 10.09.2025, e paraqitur nga A. Q. kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes martesore” dhe “gjendjes civile”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Në vitin kur kam lidhur martesën time, u ndesha personalisht me një procedurë të padrejtë: zyra e gjendjes civile refuzonte të pranonte pasaportën biometrike si dokument identifikimi, duke më detyruar të paraqisja ekskluzivisht kartën e identitetit. Ky kusht:

- nuk bazohet në asnjë nen të Ligjit nr. 10 129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i cili përdor termin dokument identifikimi të vlefshëm”;
- është në kundërshti, me Ligjin nr. 8668, datë 18.10.2000 “Për pasaportën biometrike” dhe Ligjin nr. 9979, datë 25.07.2008 “Për kartën e identitetit”, ku të dyja dokumentet njihen si mjete të vlefshme identifikimi;
- bie ndesh edhe me parimet kushtetuese të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, pasi kufizon padrejtësisht të drejtën e qytetarëve që zotërojnë vetëm pasaportë biometrike.

Ky problem nuk është vetëm personal, por përsëritet vazhdimisht për shumë qytetarë shqiptarë të tjerë, të cilët, për shkak të procedurave të brendshme jo të bazuara në ligj, përjashtohen ose vihen në vështirësi për të ushtruar një të drejtë themelore civile siç është lidhja e martesës.”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, si dhe marrjen e masave, si më poshtë:

- Të sqarohet zyrtarisht, me një udhëzim publik, vlefshmëria e pasaportës biometrike si dokument identifikimi pranë zyrave të gjendjes civile, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Të ndalohet praktika diskriminuese e refuzimit të pasaportës dhe detyrimit të qytetarëve për të paraqitur vetëm kartën e identitetit.
- Të garantohet unifikimi i procedurave në të gjitha zyrat e gjendjes civile, duke shmangur praktikat arbitrare që cenojnë të drejtat e qytetarëve.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet *ndaj çdo veprimi apo mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, konstatohet se:

Në ankesën objekt shqyrtimi A. Q., pretendon se është diskriminuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan, për shkak të gjendjes martesore dhe gjendjes civile.

Në nenin 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet kur: .... (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërës prej kushteve të mësipërme.

Referuar informacionit të cituar në rubrikat 7 dhe 8 të formularit të ankesës, rezulton se ankuesi ka theksuar se situata e pretenduar e diskriminimit dhe koha kur ai ka marrë dijani mbi të lidhen me muajin shtator të vitit 2022. Pra, evidentohet se situata e pretenduar e diskriminimit ka ndodhur në muajin shtator 2022, si dhe ai ka marrë dijani lidhur me të po në të njëjtën periudhë, shtator 2022.

Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është 10.09.2025. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton 3 (vjet) nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijani mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 191, datë 10.09.2025 pranë KMD-së.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se LMD, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: “*Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës*”.

Nga ana tjetër, LMD, në nenin 36, pikat 1, 3, 4, të tij, parashikon se: “*1. Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34<sup>2</sup> të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje*”.

.....

*3. Gjykata e njofton Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim.*

*4. Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen.”*

<sup>1</sup> Për analogji shih vendimet nr. 167, datë 23.08.2023; nr. 158, datë 28.05.2024; nr. 56, datë 12.03.2025 dhe nr. 118, datë 12.05.2025 të Komisionerit.

<sup>2</sup> “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”.

Duke qenë se subjekti ankues është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj<sup>3</sup>, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t'i drejtohet gjykatës kompetente.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 33, pika 4, germa “dh” të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 191, datë 10.09.2025, të paraqitur nga A. Q. kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja martesore dhe civile)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)

---

<sup>3</sup> Neni 36 i ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar: “*Procedura para gjykatës*”.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)